



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 22 korrik 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 21(4)(a), 38(4) dhe 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 9(5)(a), 76, 77, 86(3) dhe 97(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 tetor 2020, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) (bashkërisht “të Akuzuarit”),<sup>2</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi aktakuzën e konfirmuar, me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Aktakuza e Konfirmuar”).<sup>3</sup>

2. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës” (“Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës”).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Konfirmimit”), 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F00026/CONF/RED. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidenciale, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcat 2-3, konfidenciale. Versioni i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar, në të cilin u korrigjuan disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00045/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00045/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00045/A03). Një version konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 11 dhjetor 2020 (F00134). Aktakuza e konfirmuar e korrigjuar më tej u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED). Një version konfidencial me më pak redaktime i aktakuzës së konfirmuar u dorëzua më 17 janar 2022, F00647/A01.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 22 korrik 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00413/RED.

3. Më 23 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)” në të cilin urdhëroheshin palët të dorëzonin përgjigjet dhe kundërpërgjigjen e tyre, sipas rastit, në lidhje me pyetjen nëse materiali mbështetës i ndryshimeve të konsideruara si akuza të reja mbështet konstatimin se ekziston dyshim i bazuar mirë në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores.<sup>5</sup>

4. Më 22 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, me kërkesë të ZPS-së,<sup>6</sup> konfirmoi ndryshimet e Aktakuzës së Konfirmuar në lidhje me: (i) dy qendra ndalimi në Budakovë dhe Semetishtë, komuna e Suharekës, në të cilat ose në lidhje me të cilat anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) pretendohet se kanë kryer vepra penale të përndjekjes, burgimit/ndalimit arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore/trajtimit mizor, torturës, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë (“kategoria e parë”); dhe (ii) dy incidente të përndjekjes dhe vrasjes së paligjshme që pretendohet se janë kryer në lidhje me qendrën e ndalimit në Gjilan dhe një modifikim të periudhës për qendrën e ndalimit të Gjilanit (“kategoria e dytë”), dhe urdhëroi ZPS-në të dorëzonte ndër të tjera një aktakuzë të ndryshuar (“Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve”).<sup>7</sup>

5. Më 29 prill 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar (“Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar”) dhe dokumentet lidhur me të, përfshirë përmbledhjet

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00635, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)* (“Vendimi lidhur me Kërkesën për Ndryshim”), 23 dhjetor 2021, konfidencial, para. 48, 53(d), (e). Një version i redaktuar publik u dorëzua më 14 shkurt 2022, F00635/RED.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00455, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)* (“Kërkesa për Ndryshim”), 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 shtator 2021, F00455/CONF/RED dhe F00455/RED, përkatësisht.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 185(a)-(c), (f)-(g). Një version i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F00777/CONF/RED. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2022, F00777/RED. Një version konfidencial me më pak redakte u dorëzua më 16 maj 2022, F00777/CONF/RED2.

për akuzat e reja (“Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë” dhe (“Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Dytë”).<sup>8</sup>

6. Më 10 maj 2022, u mbajtën ndarazi paraqitje të mëtejshme në lidhje me akuzat e reja për z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi.<sup>9</sup> Në paraqitjen e mëtejshme të z. Thaçi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake informoi se afati 21-ditor për dorëzimin e mocioneve paraprake në pajtim me rregullat 90(4) dhe 97 të Rregullores fillonte më datën e paraqitjes së mëtejshme.<sup>10</sup>

7. Më 31 maj 2022, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi mocionin e saj për mangësi në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar (“Mocioni”).<sup>11</sup>

8. Më 10 qershor 2022, ZPS-ja iu përgjigj Mocionit (“Përgjigjja”).<sup>12</sup> Mbrojtja e Thaçit nuk u kundërpërgjigj.

9. Më 30 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shtyu për 22 korrik 2022 afatin për dhënien e këtij vendimi.<sup>13</sup>

---

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00789, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dokumenteve lidhur me të*, 29 prill 2022, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, shtojcat 2-4, konfidenciale dhe shtojcat 5-7, publike. Ky parashtrim i protokolluar përfshin versionet rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00789/A01), të redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe të redaktuar publik (F00789/A05) të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar. Ky parashtrim përfshin edhe përmbledhje konfidenciale me më pak redaktime dhe publike me më pak redaktime për akuzat e reja të konfirmuara; (F00789/A03 dhe F00789/A06 për Kategorinë e Parë) dhe (F00789/A04 dhe F00789/A07 për Kategorinë e Dytë).

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00794, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës për Paraqitjet e Mëtejshme dhe Çështje të Lidhura me To*, 2 maj 2022, publik, para. 9, 13(a). *Shih edhe* Transkript i Seancave, 10 maj 2022, publik.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i Seancës, 10 maj 2022, publik, f. 1175, rreshtat 5-8.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00824, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion që Pretendon Mangësi në Aktakuzën kundër z. Hashim Thaçi*, 31 maj 2022, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00835, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 10 qershor 2022, publike.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00859, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Ndryshimin e Afatit*, 30 qershor 2022, publik.

## II. PARASHTRIMET

10. Mbrojtja e Thaçit parashtron se akuzat e reja të konfirmuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake kanë mangësi për shkak të mungesës së konkretësisë dhe gabimeve të konsiderueshme në argumentim. Mbrojtja e Thaçit kërkon t'i jepet urdhër ZPS-së të japë hollësi më konkrete për sjelljen e pretenduar të z. Thaçi dhe, nëse nuk e bën këtë, t'i jepet urdhër të pakësojë, ngushtojë ose eliminojë akuzat që kanë këto mangësi.<sup>14</sup> Mbrojtja e Thaçit parashtron se kur ZPS-ja është në dijeni të fakteve materiale dhe në fazën e procedurës paraprake dalin në pah mangësi të aktakuzës, atëherë ZPS-ja nuk mund të argumentojë se do t'i korrigojë të gjitha mangësitë nëpërmjet materialit mbështetës të aktakuzës apo materialit të dorëzuar pas aktakuzës.<sup>15</sup> Parashtrohet gjithashtu se akuzat e reja të cilat i janë shtuar Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar:<sup>16</sup> (i) përgjithësisht nuk i përmendin identitetet e kryesve, me përjashtim të shprehjeve përgjithësuese "anëtarë të UÇK-së";<sup>17</sup> (ii) janë palejueshmërisht të mjegullta në lidhje me identitetet e viktimave;<sup>18</sup> (iii) janë të mjegullta në lidhje me vendin e krimeve të caktuara;<sup>19</sup> dhe (iv) nuk japin hollësi të mjaftueshme për lidhjen e z. Thaçi me krimet si edhe për rolin për të cilin akuzohet se ka luajtur.<sup>20</sup>

11. ZPS-ja përgjigjet se Mocioni nuk ka vërtetuar asnjë mangësi në formën e Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar dhe duhet rrëzuar.<sup>21</sup> ZPS-ja argumenton se parashtrimet që kanë të bëjnë me paragrafin 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar nuk kanë bazë ligjore dhe duhen rrëzuar pa u shqyrtuar, duke qenë se pretendimet e kundërshtuara janë jashtë kuadrit të ndryshimit që i është bërë

---

<sup>14</sup> Mocioni, para. 1, 27.

<sup>15</sup> Mocioni, para. 14.

<sup>16</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 93, 105, 157 dhe 174.

<sup>17</sup> Mocioni, para. 17, 19-21.

<sup>18</sup> Mocioni, para. 17, 22.

<sup>19</sup> Mocioni, para. 17, 23.

<sup>20</sup> Mocioni, para. 17, 24-26.

<sup>21</sup> Përgjigjja, para. 1, 9.

atij paragrafi.<sup>22</sup> ZPS-ja parashtron gjithashtu se Mocioni: (i) paraqet argumente të cilat janë marrë një herë në shqyrtim dhe janë rrëzuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake; (ii) kërkon në mënyrë të papërshtatshme hollësi provash të cilat nuk janë të nevojshme të paraqiten në aktakuzë; dhe (iii) kundërshton disa pretendime të marra veças e jo në tërësinë e Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.<sup>23</sup> ZPS-ja parashtron se kryesit dhe vendngjarjet përkatëse identifikohen mjaftueshëm dhe roli i të akuzuarve në krimet për të cilat janë ngritur akuza të reja është argumentuar në mënyrë adekuate.<sup>24</sup> ZPS-ja argumenton gjithashtu se, duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë se format e përgjegjesisë penale të përfshira në aktakuzë janë argumentuar me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme, nuk është e nevojshme të jepen hollësi shtesë për lidhjen apo rolin e pretenduar të të akuzuarve.<sup>25</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

#### A. MOCIONET PARAPRAKE

12. Në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr vendim në lidhje me çdo mocion paraprak, përfshirë edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës.

13. Në pajtim me rregullën 97(1)(b) të Rregullores, të akuzuarit mund t'i paraqesin në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit mocione paraprake Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të cilat pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës.

---

<sup>22</sup> Përgjigjja, para. 2, poshtëshënimi 6.

<sup>23</sup> Përgjigjja, para. 3.

<sup>24</sup> Përgjigjja, para. 4-8.

<sup>25</sup> Përgjigjja, para. 8.

## B. AKTAKUZA

14. Në pajtim me nenin 21(4)(a) të Ligjit, i akuzuari njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij.

15. Në pajtim me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një përshkrim të shkurtër të fakteve të çështjes dhe të veprës ose veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari dhe në veçanti formën e përgjegjesisë penale të pretenduar në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet.

## C. LEJA PËR APELIM

16. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej panelit.

17. Në pajtim me rregullën 76 të Rregullores, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Rregullore, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes, në qoftë se ka një të tillë, dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

18. Në pajtim me rregullën 77(1) të Rregullores, kur një palë kërkon të apelojë një vendim që nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe Rregullores, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim të ndërmjetëm panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda 7 (shtatë) ditësh prej daljes së vendimit.

## IV. STANDARDET E PËRGJITHSHME: FORMA E AKTAKUZËS SË NDRYSHUAR TË KONFIRMUAR

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se vijon të orientohet nga standardet e përgjithshme të parashtruara në paragrafët 27 deri 41 të Vendimit të Parë mbi

Mangësitë në Formën e Aktakuzës, me përcaktimet e mëtejshme të Gjykatës së Apelit.<sup>26</sup> Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se një aktakuzë përmban mangësi kur nuk paraqet faktet mbi të cilat mbështeten akuzat e ngritura ose kur këto fakte paraqiten në mënyrë të pamjaftueshme ose të paqartë, duke krijuar kështu paqartësi lidhur me akuzat e ngritura, përfshirë edhe format e përgjegjesisë, dhe duke e dëmtuar kështu aftësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur.<sup>27</sup>

20. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se konstatimet e lartpërmendura do të shërbejnë si bazë dhe orientim për vlerësimin e mëposhtëm të mangësive konkrete të pretenduara të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.

## V. DISKUTIM

21. Në fillim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake trajton parashtrimet e ZPS-së se argumentet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me paragrafin 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe duhen rrëzuar pa u marrë në shqyrtim duke qenë se pretendimet e kundërshtuara janë jashtë kuadrit të ndryshimeve, sepse është bërë vetëm një ndryshim i kufizuar i periudhës së krimeve të pretenduara.<sup>28</sup>

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij se kategoria e dytë e ndryshimeve jo vetëm që përfshinte një ndryshim të kuadrit kohor të një qendre

---

<sup>26</sup> KSC-BC-2020-04, IA004/F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës* ("Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen Shala"), 22 shkurt 2022, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA004/F00008/RED; KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake* ("Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj"), 23 qershor 2021, publik.

<sup>27</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen Shala, para. 15; Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 38; Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 40. Ngjashëm ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-AR72, Appeals Chamber, [Decision on Application by Defence for Leave to Appeal](#), 30 November 2001, para. 11; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 February 2005, para. 31; SCSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 2 March 2009, para. 329.

<sup>28</sup> Përgjigja, para. 2.



ndalimi të paraqitur më parë në aktakuzë, por edhe shtonte një viktimë, ndalimi i të cilës dallonte faktikisht nga viktimat e tjera dhe, për rrjedhojë, përbënte akuzë të re e cila kërkonte konfirmim sipas rregullës 86(3) dhe (4) të Rregullores.<sup>29</sup> Në vijim të kësaj u krye një shqyrtim i materialit mbështetës dhe u konfirmua një akuzë e re, përfshirë zgjerim të kuadrit kohor duke përfshirë muajin korrik 1999.<sup>30</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kundërshtimet që i bën Mbrojtja e Thaçit paragrafit 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar janë brenda kuadrit të këtij shqyrtimi dhe, për rrjedhojë, do të shqyrtohen duke qenë se kanë të bëjnë me ngjarjet e korrikut 1999.

#### A. IDENTITETI I KRYESVE

23. Mbrojtja e Thaçit parashtron se përshkrimi i anëtarëve të ndërmarrjes kriminale të përbashkët (“NKP”) të cilët kanë kryer drejtpërdrejt veprat penale mbi të cilat mbështeten akuzat e reja është palejueshmërisht i mjegullt.<sup>31</sup> Lidhur me paragrafët 93, 105 dhe 157 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, Mbrojtja e Thaçit parashtron se kryesit e drejtpërdrejtë vetëm sa përmenden si “anëtarë të UÇK-së” pa referim të mjaftueshëm kohor dhe gjeografik.<sup>32</sup> Sa i takon paragrafit 68 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, Mbrojtja e Thaçit parashtron se, megjithëse janë dhënë disa hollësi shtesë, nëse ZPS-ja ka hollësi të tjera si emri i kryesit, atëherë duhej të jepet edhe ky informacion.<sup>33</sup> Lidhur me paragrafin 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, Mbrojtja e Thaçit vëren se nuk është dhënë asnjë hollësi në lidhje me kryesit e drejtpërdrejtë.<sup>34</sup>

---

<sup>29</sup> Vendimi mbi Kërkesën për Ndryshim, para. 25, 28.

<sup>30</sup> Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 127-133.

<sup>31</sup> Mocioni, para. 19.

<sup>32</sup> Mocioni, para. 19-21.

<sup>33</sup> Mocioni, para. 21.

<sup>34</sup> Mocioni, para. 21.

24. ZPS-ja përgjigjet se nuk është e nevojshme të paraqiten hollësi të tjera shtesë lidhur me kryesit dhe se këto përbëjnë aspekte provash për fazën e gjyqimit.<sup>35</sup> ZPS-ja argumenton se kryesit e drejtpërdrejtë janë identifikuar sipas kategorive ose grupeve dhe janë lidhur me bazat, shtabet, ngjarjet dhe periudhat kohore dhe, në disa raste, me brigadat dhe zonat operative.<sup>36</sup> Sa i takon paragrafit 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, ZPS-ja argumenton se kur lexohet së bashku me pjesët e tjera përkatëse të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, kryesit e drejtpërdrejtë janë të identifikuar në mënyrë të mjaftueshme.<sup>37</sup>

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, kur pretendohet përgjegjësi penale sipas një NKP-je, aktakuza duhet të përcaktojë ndër të tjera identitetet e anëtarëve të saj, së paku sipas kategorive ose grupit, dhe duhet të japë identitetin e tyre konkret kur ky dihet.<sup>38</sup> Shkalla e konkretësisë e cila duhet dhënë në një aktakuzë varet nga natyra dhe rrethanat e çështjes dhe sidomos nga afërsia e të akuzuarve me ngjarjet ose veprat penale bazë dhe shkalla e veprave penale të pretenduara.<sup>39</sup> Kur afërsia e të akuzuarit me sjelljen kriminale të pretenduar është e madhe, kriteret e argumentimit janë më të rrepta.<sup>40</sup>

26. Në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar, NKP-ja e pretenduar përfshin së paku tetë individë të identifikuar me emër, krahas të akuzuarve,<sup>41</sup> dhe vepra penale të kryera në 42 vendngjarje<sup>42</sup> gjatë periudhës nga marsi 1998 deri në shtator 1999.<sup>43</sup> Akuzat e reja në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar nuk pretendojnë

---

<sup>35</sup> Përgjigjja, para. 4.

<sup>36</sup> Përgjigjja, para. 4.

<sup>37</sup> Përgjigjja, para. 4.

<sup>38</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 16; Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45. *Shih edhe* Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 35.

<sup>39</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 17; Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 42.

<sup>40</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 17; Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 43.

<sup>41</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 35.

<sup>42</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 58-177.

<sup>43</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 16.

pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të të akuzuarve në këto vepra penale të pretenduara.<sup>44</sup> Në bazë të llojit dhe shkallës së krimeve të përfshira në aktakuzën e kësaj çështjeje dhe të formave të përgjegjesisë të argumentuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se nuk është nevoja të paraqitet identiteti konkret i kryesve fizikë të krimeve për të cilat janë ngritur akuzat e të reja. Mirëpo, siç vërehet më lart, kur ZPS-ja është në gjendje t'i identifikojë me emër kryesit e pretenduar, duhet ta bëjë këtë gjë.<sup>45</sup>

27. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kryesit fizikë<sup>46</sup> të krimeve të reja të pretenduara identifikohen sipas grupeve dhe përkatësisë ("anëtarë të UÇK-së" ose "ushtar i UÇK-së").<sup>47</sup> Në disa raste këta kryes lidhen me zona operative dhe njësi konkrete<sup>48</sup> ose shtabe konkrete të UÇK-së.<sup>49</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se paragrafi 174 i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar nuk i identifikon kryesit sipas përkatësisë në grup apo mënyra të tjera, por kur lexohet së bashku me paragrafin 135, kryesit e pretenduar mund të identifikohen si "anëtarë të UÇK-së", duke i përshkruar më tej si të lidhur me një periudhë dhe vendndodhje konkrete. Megjithatë, për të shmangur çdo paqartësi, ZPS-ja duhet të përfshijë frazën "anëtarë të UÇK-së" në paragrafin 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.

28. Sa i takon akuzës së re për akte të tjera çnjerëzore dhe trajtim mizor në lidhje me kategorinë e parë të ndryshimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo akuzë pretendon se "disa anëtarë të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat psikologjikisht", duke i lidhur më tej ata me një

---

<sup>44</sup> *Shih* Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 93, 105, 135, 157.

<sup>45</sup> *Shih më lart*, para. 25; Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 16; Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45, 50.

<sup>46</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake përdor termin "kryes fizikë" për individët të cilët pretendohet se i kanë kryer drejtpërdrejt krimet për të cilat akuzohen të akuzuarit nëpërmjet formave të ndryshme të përgjegjesisë të përmendura në Aktakuzën e Konfirmuar. *Shih edhe* Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, poshtëshënimi 241; Vendimi i Konfirmimit, para. 108.

<sup>47</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 93, 105, 135, 157.

<sup>48</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 157.

<sup>49</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 93, 135.

periudhë dhe vendndodhje konkrete.<sup>50</sup> Në materialin mbështetës në disa raste përmenden me emër anëtarët e UÇK-së që pretendohet se i kanë kryer këto keqtrajttime,<sup>51</sup> dhe pretendimet kundër këtyre kryesve janë konfirmuar.<sup>52</sup> Për rrjedhojë, kur ZPS-ja është në gjendje të përmendë me emër kryesit e drejtpërdrejtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këta emra duhen shtuar në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar. Rrjedhimisht, ZPS-ja duhet ta ndryshojë paragrafin 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar duke përfshirë emrat e kryesve të drejtpërdrejtë të përmendur shprehimisht në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b) të Ndryshimeve të Kategorisë së Parë.

29. Sa i takon akuzës së re për vrasje të paligjshme në lidhje me kategorinë e parë të ndryshimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren kjo akuzë thotë se u dha një urdhër për transferimin e viktimave dhe se pak kohë pas kësaj u krye transferimi nga anëtarë të UÇK-së, duke i lidhur këta më tej me një periudhë kohore, brigadë të UÇK-së dhe vendndodhje konkrete.<sup>53</sup> Në materialin mbështetës për këtë akuzë të re përmendet me emër individ i cili urdhëroi transferimin e viktimave si edhe anëtari i UÇK-së i cili i shoqëroi viktimat gjatë transferimit,<sup>54</sup> Këto pretendime u konfirmuan më pas.<sup>55</sup> Për rrjedhojë, kur ZPS-ja është në gjendje t'i përmendë me emër anëtarët e UÇK-së të përfshirë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këto emra duhen shtuar në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar. Rrjedhimisht, ZPS-ja duhet ta ndryshojë paragrafin 157 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar duke përfshirë emrat e anëtarëve të UÇK-së të përmendur shprehimisht në faqen 25 të Përmbledhjes sipas Rregullës 86(3)(b) të

---

<sup>50</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 105.

<sup>51</sup> Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë, f. 13-15, 18-19. *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, F00709, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Korrigjuar të Prokurorisë dhe Kërkesave në lidhje me Të, 24 shkurt 2022, publik, me Shtojcat 1 dhe 3, repretësisht* konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale, para. 390.

<sup>52</sup> Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 69.

<sup>53</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 157.

<sup>54</sup> Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë, f. 25.

<sup>55</sup> Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 89.

Ndryshimeve të Kategorisë së Parë dhe të referuar në këtë paragraf të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.

30. Sa u takon akuzave të reja mbi të cilat mbështetet kategoria e dytë e ndryshimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në paragrafin 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, pretendohet se anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën tre persona në shtabin e UÇK-së në ish-shkollën dhe konviktin në Gjilan.<sup>56</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se në paragrafin 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, pretendohet se anëtarë të UÇK-së i çuan dy viktimat drejt konviktit të Gjilanit <sup>57</sup> të cilët nuk u panë më kurrë. Identiteti konkret i kryesve të drejtpërdrejtë të këtyre krimeve të pretenduara nuk përmendet në materialin mbështetës të akuzave të reja<sup>58</sup> dhe, rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konfirmuar vetëm se këta individë janë anëtarë të UÇK-së, të përshkruar më tej si të lidhur me një periudhë dhe vendndodhje konkrete.<sup>59</sup> Duke qenë se nuk duket se ZPS-ja është në dijeni të identiteteve të kryesve të drejtpërdrejtë, nuk kërkohen hollësi të tjera shtesë.

31. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të ndryshojë paragrafët 105, 157 dhe 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar sipas mënyrës së përshkruar më lart<sup>60</sup> dhe, deri të premtën, 30 shtator 2022, të bëjë redaktimet e domosdoshme në përputhje me masat mbrojtëse të autorizuara.

## B. IDENTITETET E VIKTIMAVE

32. Mbrojtja e Thaçit parashton se paraqitja e identiteteve të viktimave në paragrafët 68, 93 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar është

---

<sup>56</sup> Akuzat e reja kanë të bëjnë vetëm me ngjarje të korrikut 1999.

<sup>57</sup> *Shih më lart*, para. 27.

<sup>58</sup> Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Dytë, f. 2, 5-13.

<sup>59</sup> Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 122, 147-149.

<sup>60</sup> *Shih më lart*, para. 27-29.

palejueshmërisht e mjegullt.<sup>61</sup> Mbrojtja e Thaçit argumenton se përmendja e “të paktën dymbëdhjetë” viktimave ose “të paktën tre personave” tregon se këto nuk janë krime të një shkalle të tillë që e bën të porealizueshme konkretësinë në një masë të madhe të identiteteve të viktimave dhe, rrjedhimisht, mosdhënia e identiteteve të tyre e bën të mangët Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar.<sup>62</sup>

33. ZPS-ja përgjigjet se nuk është nevoja të jepen hollësi të tjera shtesë lidhur me viktimat dhe se këto hollësi përbëjnë aspekte provash për t’u paraqitur në gjykim.<sup>63</sup> ZPS-ja argumenton se viktimat janë identifikuar mjaftueshëm sepse janë përcaktuar sipas kategorisë dhe grupit duke përmendur numrin e përafërt minimal, vendin e ndalimit, periudhën kohore dhe të dhëna të tjera të lidhura me krimet, përfshirë në disa raste emrin, kombësinë ose përkatësinë politike të viktimës.<sup>64</sup>

34. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se nëse identiteti i viktimave përbën ose jo fakt material, kjo varet nga afërsia e pretenduar e të akuzuarve me këto ngjarje dhe nga lloji i përgjegjësisë të cilin pretendon Prokuroria.<sup>65</sup> Në rrethana të caktuara, lloji dhe shkalla e veprave penale të pretenduara e bëjnë të pamundur përcaktimin e identiteteve të viktimave. Në kësi rastesh, mund të mjaftojë identifikimi i viktimave si grup apo dhënia e numrit të përafërt të viktimave.<sup>66</sup> Mirëpo, edhe në rastet kur nuk është e realizueshme një shkallë e lartë konkretësie, në qoftë se ZPS-ja është në gjendje t’i përmendë me emër viktimat, duhet ta bëjë këtë, duke qenë se identiteti i viktimës është një informacion me vlerë për përgatitjen e mbrojtjes.<sup>67</sup>

---

<sup>61</sup> Mocioni, para. 22.

<sup>62</sup> Mocioni, para. 22.

<sup>63</sup> Përgjigjja, para. 5.

<sup>64</sup> Përgjigjja, para. 5.

<sup>65</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 26; Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 28.

<sup>66</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 26; Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 34.

<sup>67</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Çështjen *Shala*, para. 26.

35. Sa i takon identitetit të viktimave të pretenduara në akuzat e reja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit kundërshton paragrafët 68, 93 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.<sup>68</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se të gjitha viktimat përkatëse identifikohen duke përmendur të dhënat që kanë të bëjnë me krimet e pretenduara, si numri, vendi i ndalimit dhe periudha kohore.<sup>69</sup> Gjithashtu, disa identifikohen sipas përkatësisë politike.<sup>70</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se është dhënë informacion i hollësishëm lidhur me viktimat e akuzave të reja, sidomos nëse mbahet parasysh: (i) lloji dhe shkalla e veprave penale për të cilat janë ngritur akuzat, në veçanti fakti se pretendohet se janë kryer kundër qindra viktimave; dhe (ii) fakti se të akuzuarit nuk akuzohen se kanë kryer vetë fizikisht ndonjë prej krimeve mbi të cilat janë ngritur akuzat e reja.<sup>71</sup>

36. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se materiali mbështetës i dorëzuar në lidhje me akuzat e reja tregon qartë se ZPS-ja është në gjendje të japë identitetet e viktimave. Lidhur me paragrafët 68 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, ZPS-ja pretendon se “anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën dymbëdhjetë persona pa proces ligjor të rregullt në Budakovë” dhe se këta individë u “rrahën egërsisht dhe u keqtrajtuan psikologjikisht”. Këta dymbëdhjetë persona përmenden me emër nga ZPS-ja në Përmbledhjen e saj sipas Rregullës 86(3)(b) të Ndryshimeve të Kategorisë së Parë.<sup>72</sup> Për rrjedhojë, kur ZPS-ja mund t’i përmendë me emër viktimat përkatëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këta emra duhen shtuar në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar. Rrjedhimisht, ZPS-ja duhet të ndryshojë paragrafët 68 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar duke përfshirë emrat e viktimave shprehimisht të

---

<sup>68</sup> Mocioni, para. 22.

<sup>69</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 93, 105.

<sup>70</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 105.

<sup>71</sup> Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 128, 152.

<sup>72</sup> Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë, f. 2-10, 12-20. *Shih edhe* Vendimi i Konfirmimi të Ndryshimeve, para. 56-62, 67-72.

përmendur në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b) të Ndryshimeve të Kategorisë së Parë.

37. Në lidhje me paragrafin 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, ZPS-ja pretendon se anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën tre persona pa proces të rregullt ligjor. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se akuzat e reja kanë të bëjnë vetëm me ngjarje të korrikut 1999.<sup>73</sup> Materiali mbështetës i ZPS-së tregon për një individ i cili u mbajt i ndaluar gjatë kësaj periudhe.<sup>74</sup> Për rrjedhojë, kur ZPS-ja është në gjendje të përmendë me emër viktimën përkatëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se emri i këtij individ duhet të shtohet në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar. Rrjedhimisht ZPS-ja duhet ta ndryshojë paragrafin 93 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar duke përfshirë emrin e viktimës të përmendur shprehimisht në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b) të Ndryshimeve të Kategorisë së Dytë.<sup>75</sup>

38. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të ndryshojë paragrafët 68, 93 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar sipas mënyrës së treguar më lart<sup>76</sup> dhe të bëjë redaktimet e domosdoshme, në përputhje me masat e autorizuara mbrojtëse deri të premtën, më 30 shtator 2022.

### C. IDENTIFIKIMI I VENDEVE TË KRIMEVE

39. Mbrojtja e Thaçit parashton se paraqitja e vendit të kryerjes së krimeve të pretenduara në paragrafët 68, 105 dhe 157 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar është palejueshmërisht e mjegullt.<sup>77</sup> Mbrojtja e Thaçit argumenton se

---

<sup>73</sup> Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Dytë, f. 2; Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 120.

<sup>74</sup> Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Dytë, f. 2-3; Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 120-124.

<sup>75</sup> Për hir të njëtrajshmërisë brenda këtij paragrafi, ZPS-ja do të duhej të përfshijë edhe emrat e viktimave të njohura në lidhje me ngjarjet në fund të qershorit 1999.

<sup>76</sup> *Shih më lart*, para. 36-37.

<sup>77</sup> Mocioni, para. 23.



faktet materiale të çështjes së ZPS-së duhen paraqitur me hollësi të mjaftueshme për ta informuar të akuzuarin në mënyrë të qartë për akuzat që janë ngritur kundër tij në mënyrë që ai të përgatisë mbrojtjen e vet.<sup>78</sup> Ajo argumenton gjithashtu se vetëm identifikimi i fshatit përkatës nuk është informacioni më i shumtë i mundshëm dhe se duhet paraqitur më shumë informacion si ndërtesa ku janë kryer krimet, në qoftë se ZPS-ja është në zotërim të këtij informacioni.<sup>79</sup>

40. ZPS-ja përgjigjet se nuk është nevoja të paraqiten hollësi të tjera shtesë lidhur me vendet e kryerjes së krimeve dhe se këto hollësi përbëjnë aspekte provash për t'u paraqitur në gjykim duke qenë se vendet e kryerjes së krimeve mbi në të cilat mbështeten akuzat e reja identifikohen mjaftueshëm sipas fshatit, komunës dhe lidhjes ose veprimtarisë së anëtarëve të UÇK-së, përfshirë në disa raste në brigadën ose zonën operative përkatëse.<sup>80</sup>

41. Sa i takon vendit të kryerjes së krimeve për të cilat janë ngritur akuzat e reja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit kundërshton paragrafët 68, 105 dhe 157 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.<sup>81</sup> Në lidhje me paragrafët përkatës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se krimet e pretenduara janë të identifikuara me emrin e fshatit ose komunës përkatëse.<sup>82</sup> Disa vendndodhje janë gjithashtu të identifikuara duke bërë lidhjen me brigadën ose zonën operative përkatëse të UÇK-së.<sup>83</sup> Rrjedhimisht Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se është dhënë informacion mjaftueshmërisht i hollësishëm sa i takon vendit të kryerjes së krimeve në për të cilat janë ngritur akuzat e reja, duke pasur parasysh llojin dhe shkallën e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat dhe faktin se të akuzuarit nuk akuzohen se i kanë kryer vetë fizikisht krimet.

---

<sup>78</sup> Mocioni, para. 23.

<sup>79</sup> Mocioni, para. 23.

<sup>80</sup> Përgjigjja, para. 6.

<sup>81</sup> Mocioni, para. 23.

<sup>82</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 105, 157.

<sup>83</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68, 157.

42. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja ka qenë në gjendje të japë në materialin mbështetës të akuzave të reja hollësi të mëtejshme lidhur me disa prej vendeve të krimeve të pretenduara, në veçanti në lidhje me burgosjen dhe ndalimin arbitrar<sup>84</sup> si edhe akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor.<sup>85</sup> Sa i takon vrasjes së paligjshme, materiali mbështetës nuk përmban hollësi të tjera në lidhje me vendin në të cilin pretendohet se është kryer krimi.<sup>86</sup> Për rrjedhojë, aty ku ZPS-ja mund të japë hollësi të mëtejshme lidhur me vendin e krimeve të pretenduara, si konkretisht vendndodhja e ndërtesës dhe/ose pronari i saj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo vendndodhje duhet shtuar në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar. Rrjedhimisht, ZPS-ja duhet të ndryshojë paragrafët 68 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar duke përfshirë vendndodhjet e përfshira në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b) të Ndryshimeve të Kategorisë së Parë.

43. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të ndryshojë paragrafët 68 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar sipas mënyrës së treguar më lart<sup>87</sup> dhe të bëjë redaktimet e domosdoshme në përputhje me masat e autorizuara mbrojtëse, deri të premtën më 30 shtator 2022,.

#### D. ARGUMENTIMI I ROLIT TË TË AKUZUARIT NË KRIMET PËR TË CILAT JANË NGRITUR AKUZAT

44. Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se paragrafët 68, 93, 105, 157 dhe 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar kanë mangësi sepse nuk paraqesin fakte materiale të përfshirjes së z. Thaçi në krimet për të cilat janë ngritur akuzat.<sup>88</sup> Mbrojtja e Thaçit

---

<sup>84</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 68; Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë, f. 2-10. *Shih edhe* Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 56.

<sup>85</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 105; Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë, f. 12-20. *Shih edhe* Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 69.

<sup>86</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 157; Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b) e Ndryshimeve të Kategorisë së Parë, f. 24-25. *Shih edhe* Vendimi i Konfirmimit të Ndryshimeve, para. 88-90.

<sup>87</sup> *Shih më lart*, para. 42.

<sup>88</sup> Mocioni, para. 24-25.

argumenton se mungesa e konkretësisë në paraqitjen e rolit dhe/ose lidhjes së tij ndërlikohet më tej nga fakti se lloji i pjesëmarrjes ose kontributit të tij personal në NKP, si ndihmues dhe inkurajues, dhe si epror është paraqitur me mangësi, dhe, për rrjedhojë, z. Thaçi nuk mund të kuptojë me saktësi se çfarë thuhet se ka bërë për të marrë pjesë në kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat e reja.<sup>89</sup>

45. ZPS-ja përgjigjet se nëse akuzat e reja lexohen së bashku me pjesën tjetër të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, del qartë se të akuzuarit janë përgjegjës nëpërmjet pjesëmarrjes në NKP, si ndihmues dhe inkurajues dhe/ose si eprorë.<sup>90</sup> ZPS-ja argumenton se, duke mbajtur parasysh konstatimin e mëparshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se format e përgjegjësisë të përfshira në aktakuzë janë paraqitur me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme, nuk është nevoja të jepen hollësi të tjera shtesë në akuzat e reja sa i takon lidhjes ose rolit të pretenduar të të akuzuarve.<sup>91</sup>

46. Sa i takon përfshirjes së z. Thaçi në krimet për të cilat janë ngritur akuzat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit kundërshton paragrafët 68, 93, 105, 157 dhe 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar.<sup>92</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se pretendohet se të akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale për akuzat e reja: (i) nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në NKP dhe/ose si ndihmues dhe inkurajues;<sup>93</sup> dhe/ose (ii) si eprorë për krime të kryera nga vartësit e tyre.<sup>94</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se asnjë prej formave të lartpërmendura të përgjegjësisë penale nuk përmban asnjë element që kërkon që të akuzuarit të kenë luajtur rol të drejtpërdrejtë në kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat.<sup>95</sup> Përkundrazi, lidhja e z. Thaçi me krimet për të cilat janë ngritur

---

<sup>89</sup> Mocioni, para. 26.

<sup>90</sup> Përgjigjja, para. 7.

<sup>91</sup> Përgjigjja, para. 8.

<sup>92</sup> Mocioni, para. 24.

<sup>93</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 32-54, 178-179.

<sup>94</sup> Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar, para. 55-57, 178-179.

<sup>95</sup> Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 174.

akuzat duhet vërtetuar nëpërmjet: (i) kontributit të tij për qëllimin e përbashkët që përbën ose përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar në Ligj (NKP);<sup>96</sup> (ii) ndihmës, inkurajimit ose mbështetjes morale nga ana e tij për kryerjen e një krimi ku kjo mbështetje ka një ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimit (ndihma dhe inkurajimi);<sup>97</sup> dhe/ose (iii) mosmarrjes nga ana e tij të masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e krimeve të vartësve të tij *de jure* ose *de facto*, ose për ndëshkimin e kryesve të krimeve të kryera nga këta vartës (përgjegjësia eprore).<sup>98</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se është konstatuar se format e përgjegjesisë penale të përfshira në aktakuzë janë paraqitur me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme.<sup>99</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është nevoja të paraqiten më tej hollësi të tjera shtesë në lidhje me akuzat e reja në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar për lidhjen e pretenduar të të akuzuarve me krimet për të cilat janë ngritur aktakuza dhe rolit që pretendohet se kanë luajtur.

#### E. PËRFUNDIM

47. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, duke mbajtur parasysh: (i) strukturën e Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar; (ii) informacionin konkret dhe të hollësishëm të dhënë; (iii) llojin dhe rrethanat e çështjes gjyqësore dhe shkallën e krimeve të përfshira në Aktakuzë; dhe (iv) faktin se të akuzuarit nuk akuzohen t'i kenë kryer vetë fizikisht asnjë prej krimeve të pretenduara për të cilat janë ngritur akuzat e reja, Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar përshkruan me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme faktet në të cilat mbështeten akuzat e reja, përfshirë format e përgjegjesisë penale për të cilat janë

---

<sup>96</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 106-110.

<sup>97</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 116.

<sup>98</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 118-121; Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 174.

<sup>99</sup> Vendimi i Parë mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 57-126.

ngritur akuzat. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se ZPS-ja është në gjendje të sigurojë konkretësi të mëtëjshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se akuzat e reja në Aktakuzën e Ndryshuar të Konfirmuar duhet ndryshuar siç tregohet në paragrafët 27-29, 36-37 dhe 42, më lart. Rrjedhimisht, kundërshtimet e tjera që ngre Mbrojtja e Thaçit lidhur me formën e Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar rrëzohen.

#### F. ZGJATJA E AFATIT PËR TË KËRKUAR LEJE PËR APELIM

48. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në pajtim me rregullën 77(1) të Rregullores, kur një palë kërkon të apelojë një vendim që nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe rregullores, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit. Duke pasur parasysh pushimin veror të gjykatës,<sup>100</sup> Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mendon të përshtatshme ta ndryshojë afatin e paraqitjes së kërkesës për leje për apelim të këtij vendimi. Rrjedhimisht, një kërkesë e tillë duhet dorëzuar jo më vonë se të premten, 19 gusht 2022. Çdo përgjigje dhe kundërpërgjigje lidhur me të duhet të respektojë afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

#### VI. VENDIM

49. Për arsytet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën pjesërisht;

---

<sup>100</sup> Pushimi veror i gjykatës fillon nga dita e hënë, 25 korrik 2022, dhe zgjat deri ditën e premte, 12 gusht 2022, shih KSCPR-2021, Kryetarja, *Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2022*, 11 nëntor 2021, publik.

- b. **URDHËRON** ZPS-në të shtojë emrat e kryesve të drejtpërdrejtë përkatës në paragrafët 105, 157 dhe 174 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar siç përcaktohet në paragrafët 27-29, më lart;
- c. **URDHËRON** ZPS-në të shtojë emrat e viktimave përkatëse në paragrafët 68, 93 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar siç përcaktohet në paragrafët 36-37, më lart;
- d. **URDHËRON** ZPS-në të shtojë vendndodhjet përkatëse në paragrafët 68 dhe 105 të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar siç përcaktohet në paragrafin 4240, më lart;
- e. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë një version rreptësisht konfidencial, një konfidencial dhe një publik të redaktuar, sipas rastit, të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar me ndryshime të mëtejshme deri të **premtën, 30 shtator 2022**; dhe
- f. **NDRYSHON** afatin për dorëzimin e kërkesave për leje për apelim të këtij vendimi dhe **URDHËRON** që kërkesat e tilla, , të dorëzohen deri të **e premtën, 19 gusht 2022**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 22 korrik 2022

Hagë, Holandë.